

## AKTI I THEMELIMIT

(Kontrata)

PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Telecom & Energy Holding"

Në Tiranë, sot më datën, 23.04.2018 (Dy mijë e tetëmbëdjetë) unë, **SADRIT DANAJ**, i biri Ferjat-it, i datelindjes 04.02.1967, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, Lagja "Pavaresia", per identitetin e te cilit u sigurova nga Leternjoftimi ID Nr.030051620 dhe Numër Personal: G70204142U, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

me cilësinë e ortakut të vetëm themelues, krijova **Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar** në përputhje me Ligjin №. 9901, datë, 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Treghtarë", sipas dispozitave që

### v i j o j n ë :

Neni 1

1.1 Shoqërinë e krijoj sipas llojit: - Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar.

Neni 2.

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është: Shoqëria "**Telecom & Energy Holding**" – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose shkurt: Shoqëria "**Telecom & Energy Holding**" – SH.P.K." që, në mjaft raste, në dokumentet e krijimit të saj, do të shkruhet edhe më shkurt: "Shoqëria" ose "**Telecom & Energy Holding**".

2.2 Selia e Shoqërisë është: - VLORE Lagjja "Pavarësia" Kulla e parë tek Rrethi Skelë kati 2.

Telefoni: 0682034923

e-mail:sadrit@nisatel.al

Neni 3.

3.1 Shoqëria do të funksionojë për një periudhë kohe të pa kufizuar.

Neni 4.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti:

Veprimtari ne fushen e telekomunikacionit.

Ndertim dhe shfrytezim rrjetesh telekomunikacioni si dhe ofrimi i sherbimeve në këtë fushë, internet, telefon, tv dhe sherbime të tjera me vlere te shtuar.

Veprimtari Radio Televizive.

Veprimtari ne fushen e energjise elektrike.

a.Prodhimin e energjisë elektrike; b.Operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike; c. Operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike; d.Furnizimin e energjisë elektrike; e.Tregtimin e energjisë elektrike; ë.

Operimin e Tregut të energjisë elektrike; f.Sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Veprimtari ne fushen e ndertimit, hotelerise, bar-restorant, turizmit, agro-turizmit, transportit uJOR e tokesor... Import export, shitje me pakicë dhe shumicë të produkteve dhe të nënprodukteve blegtorale, bujqësore, bimë medicinale, farmaceutike si dhe shfrytëzim dhe përpunim i tyre. Përpunimi dhe

Reciklimi i mbetjeve dhe materialeve të ngurta urbane si dhe i mbetjeve të tjera ndotëse dhe të rrezikshme.

Nxjerrja dhe përpunimi i lëndëve dhe materialeve nëntokësore.

Përpunimin e ujit të pijshëm, tregëtimin e tij me shumicë dhe pakicë, të ambalazhuar ose jo.

#### Neni 5.

##### Regjimi juridik.

5.1 Në të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet dhe zbaton me korrektësi legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.2 Të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese të shoqërisë dhe themeluesit (ortakut të vetëm të saj) përcaktohen më hollësisht në Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

5.3 Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.4 Për evidentimin e veprimtarisë, Shoqëria do të përdorë dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit, siç sqarohet më hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë.

5.5 Shoqëria gëzon **afirmim ligjor** që nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5.6 **Administratori** i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët (brënda dhe jashtë vendit) është: **NDUE GURI**.

5.7. Administratori i Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe **5 (pesë) vjeçare**, duke filluar qysh nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### Neni 6.

##### Kapitali i Shoqërisë.

6.1 Fillimisht, Kapitali themeltar i Shoqërisë është:

a) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë.

Z. **SADRIT DANAJ** zotëron 100 % (njëqind) te kapitalit themeltar te shoqërisë, e barabartë me 1(një) kuotë e barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë.

b) Kapitali në natyrë:

Krahas ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, si dhe të mundësive ekonomiko – financiare që do t'i krijohen, kontributet e saj mund të jenë edhe në natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme ose në të drejta të vlerësueshme në para), siç do të vendos në të ardhmen unë, ortakut të vetëm i Shoqërisë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë do të rritet ose do të zvogëlohet në përputhje me ecurinë e veprimtarisë së saj ekonomiko - financiare dhe tregëtare, si dhe të vendimeve që do të marr në të ardhmën, unë, ortakut të vetëm i saj.

#### Neni 7.

##### Organet e drejtimit të shoqërisë

7.1 a) Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.



7.2 Të drejtat dhe përgjegjësitë e administratorit dhe përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë saktësohen hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

7.3 Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i Shoqëri, sipas nevojave që do t'i paraqiten Shoqërisë për drejtimin e veprimtarisë së saj, në të ardhmen do të vendosë edhe për krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për drejtim, si: drejtor, zëvendës-drejtor, etj.

7.4 Për çdo çështje profesionale, si: për çështje juridike, ekonomike, financiare, teknike etj. Shoqëria do të punësojë dhe angazhojë (emërojë), sipas rastit, juristë, ekonomistë, financierë, teknikë, ekspertë etj. në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

#### Neni 8.

8.1 Pasuria e Shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në institute të tjera shtetërore dhe private ekzistuese dhe ato që mund të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi.

8.2 Masa e pasurisë që do sigurohet, si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga organet drejtuese të Shoqërisë sipas kompetencave që do t'u japë Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i saj.

#### Neni 9.

##### Ndarja e fitimeve.

9.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, si dhe personave të tretë fizikë dhe juridikë, fitimi netto i Shoqërisë më kalon mua, ortakut të vetëm të saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9.2 Me vendim të Administratorit dhe përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë, fitimi ose një pjesë e tij, mund të investohet për zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Shoqërisë.

#### Neni 10.

##### Likujdimi i Shoqërisë.

10.1 Rastet dhe likujdimi i Shoqërisë, si dhe ajo e mbarimit të afatit të Aktit të themelimit të Shoqërisë përcaktohen në Statutin e saj.

10.2 Ky Akt Themelimi (kontrata) për krijimin e Shoqërisë mund të zgjidhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

10.3 Në rastet e likujdimit përfundimtar të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me dispozitat e Statutit të saj, pushon së vepruari edhe Akti i themelimit (kontrata) e krijimit të Shoqërisë.

#### Neni 11.

##### Dispozita të përgjithshme.

11.1 Ky Akt për themelimin e Shoqërisë (kontrata) ka si pjesë përbërëse të tij edhe Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkëngjitet dhe depozitohet në organet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

11.2 Adresa ligjore e Shoqërisë është: VLORE Lagjja "Pavarësia" Kulla e parë tek Rrethi Skelë kati 2.

Telefoni: 0682034923

e-mail:sadrit@nisatel.al

11.3 Çdo ndryshim apo shtesë që mund t'i bëhet këtij Akti për themelimin e Shoqërisë (kontratës) dhe Statutit, duhet të bëhet me shkrim, të nënshkruhet nga unë, ortaku i vetëm i saj ose përfaqësuesi im dhe do të depozitohet si në



dokumentet e Shoqërisë që mbahen në selinë e saj, ashtu edhe në organet përkatëse, të detyrueshme me ligj.

114 Ky Akt - Themelimi i Shoqërisë (kontrata) u hartua në tri ekzemplarë të barabartë dhe u nënshkrua nga themeluesi i Shoqërisë “ **Telecom & Energy Holding** ” – SH.P.K.

Një kopje e këtij Akt Themelimi do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Z. Elson Kosta.

ORTAK I VETEM

I SHOQERISE “**Telecom & Energy Holding**” – SH.P.K.

A handwritten signature in black ink, reading "Sadrit Janaj", is written over a horizontal line. Below the signature, there is a circular stamp or mark, possibly a seal or a date stamp, which is partially obscured by the signature.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE - TIRANE

N<sup>o</sup>. 2533 Rep.

N<sup>o</sup>. — Kol.

### VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë, sot më, 23.04.2018 (Dymijë e tetëbëdhjetë), para meje, Notere ARTEMISA MEÇAJ (ARAPI), e regjistruar në Dhomën e Noterëve, Tiranë, me zyrë në Rr. "Durrësit", N<sup>o</sup>.81, u paraqit personalisht:

**SADRIT DANAJ**, i biri Ferjat-it, i datelindjes 04.02.1967, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, Lagja "Pavaresia", per identitetin e te cilit u sigurova nga Leternjoftimi ID Nr.030051620 dhe Numër Personal: G70204142U, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

I lartpërmenduri më deklaroi se dokumentin e mesiperm "**Akti i Themelimit**" të Shoqërisë "**Telecom & Energy Holding**" – SH.P.K., "**Shoqëri në krijim e sipër**", e ka redaktuar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë jashtë kësaj zyre dhe e nënshkroi në praninë time, ndërsa unë, Noterja, e vërtetoj rregullisht, në përputhje me Nenit 55 të Ligjit 7829 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

